

**VENDIM****Nr. 892, datë 17.12.2014**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA  
NË VENDIMIN NR. 668, DATË 15.10.2014,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR  
KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E  
SHKOLLIMIT NË INSTITUCIONET  
PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR  
PROGRAMET E STUDIMEVE TË  
CIKLIT TË DYTË ME KOHË TË PLOTË  
“MASTER PROFESIONAL” DHE  
“MASTER I SHKENCAVE” APO  
“MASTER I ARTEVE TË BUKURA”, PËR  
VITIN AKADEMIK 2014 - 2015”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 34, 36 e 75, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye ose për shkak të detyrës”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 668, datë 15.10.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesa, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 3, bëhen këto ndryshime:
  - a) Në paragrafin e parë, shifra “6547” bëhet “6567”.
  - b) Në shkronjën “a”, shifra “6397” bëhet “6417”.
2. Në shkronjën “a”, të pikës 4, shifra “6087” bëhet “6107”.
3. Në pikën 21, data “16.12.2014” ndryshohet

dhe bëhet “31.12.2014”.

4. Kudo në vendim fjalët “...tabelat/ve nr. 1, nr. 1/1 dhe nr. 2,...” zëvendësohen me fjalët “...tabelat/ve nr. 1, nr. 1/1, nr. 2 dhe nr. 2/2...”.

5. Pas tabelës nr. 2, bashkëlidhur vendimit, shtohet tabela 2/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**



Tabela nr. 2/2

KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT, NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË “MASTER I SHKENCAVE”/“MASTER I ARTEVE TË BUKURA”, PËR VITIN AKADEMIK 2014-2015

| Emërtimi i universitetit         | ID_Programit | Emërtimi i programit | Kuotat e pranimi për kandidatët brenda territorit të vendit | Tarifa për kredit për program të parë studimi (në lekë) | Tarifa për kredit për program të dytë studimi (në lekë) |
|----------------------------------|--------------|----------------------|-------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------|
| Universiteti i Mjekësisë, Tiranë | 216          | Logopedi             | 20                                                          | 1,750                                                   | 2,625                                                   |